



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 355/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesuese, Faton Ademi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Besart Ademi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik-koalicionit NISMA-AKR-PD, paraqitur kundër komisionarëve të Qendrës së Votimit 2042A, në vendvotimin 17R dhe 25R në Prizren, për shkak të parregullsive në ditën e votimit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës te datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 08.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET e pa lejuar ankesa e Zafir Berisha kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik-koalicionit NISMA-AKR-PD, paraqitur kundër komisionerëve të Qendrës së Votimit 2042A, në vendvotimin 17R dhe 25R në Prizren, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës te datës 06.10.2019, me kërkesë për rinumërim në këto vendvotime.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 07.10.2019, nga Zafir Berisha kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik-koalicionit NISMA-AKR-PD, paraqitur kundër KQZ-së, duke pretenduar se në Qendrën e Votimit nr.2042A, 17R dhe në 25R në Prizren, për shkak të formularit me gabime votat e subjektit politik NISMA-AKR-PD me numër.122, i janë bartur subjektit politik Lista Srbska me numër 121.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli me rastin e vendosjes, nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljet e pretenduara në ankesë përkitazi me parregullsitë në Qendrën e Votimit nr.2042A, 17R, dhe në 25R, në Prizren, dhe kërkesa është për rinumërim në këto vendvotime, e cila kërkesë, për faktin se lidhet me shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, duhet të

parashtrihen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës.

Meqenëse pala ankuese kërkesë kryesore e ka rinumërimin për shkak të pretendimeve se gabimet teknike në FRP-të, kanë ndikuar në rezultatit e votave të tij, në këtë fazë të procesit zgjedhor të gjitha ankesat që i referohen kontestimit të rezultateve hudhen poshtë si të palejuara sepse rezultatet nuk janë përfundimtare dhe të njëjtat mund të ndryshojnë, e po ashtu korrektimi i gabimeve teknike që i referohen ankuesit, në raport me FPR, tani për tani është në kompetencë të KQZ-së, për korrektim me rastin e auditimit të të gjithave FRP-ve, sipas procedurave të Qendrës së Numërimit të Rezultateve (QNR), konform Rregullës Zgjedhore Nr.06/2013. Pas auditimit të tërësishëm të FRP-ve, QNR-ja, harton raportin me shkrim të rezultateve përfundimtare dhe i njëjti publikohet nga KQZ-ja, ku palët me interes ligjor të njëjtin mund ta ankimojnë.

Në rastin konkret derisa nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hedhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hedhja e ankesës së kandidatit për deputet Zafir Berisha, për zgjedhjet e përkohshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A nr. 355/2019 më datën 08.10.2019

Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.*